



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 2450

Prishtinë, Dt. 15.07.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Kimi/ Kimi fizike dhe inorganike
Projektpropozimi	“Faktorët e bioakumulimit dhe zhvendosjes së metaleve nga bimët e familjes Brassicaceae në masivin e Goleshit”/ “Bioaccumulation and translocation factors of metals from plants of the Brassicaceae family in the Golesh massif”
Kandidati	Violeta Hajdari
Mentori	Prof. Dr. Musaj Paçarizi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 31.05.2023
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 2477

Vlerësimi i dorëshkrimit

**Shënimet e përgjithshme**

Punimi i Masterit i kandidates **Violeta Hajdari** ka 60 faqe tekst me rrallim normal. Në punim janë 7 tabela dhe 18 figura. Janë cituar 43 burime të literaturës. Punimi përmban abstrakt dhe rezyme në gjuhën shqipe e angleze. Jetëshkrimi është në fund të punimit.

Punimi përban kapitujt: **Hyrje, Qëllimi dhe rëndësia e punimit, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet e hulumtimit dhe diskutimi, Përfundime, Literatura, Rezyme, Summary dhe Jetëshkrimi.**

### **Analiza e Punimit**

Në Hyrje kandidatja paraqet të dhëna të përgjithshme për tokat serpentine në Kosovë, shpërndarjen e tyre, karakteristikat e këtyre tokave, përbërjen kimike të tokave serpentine të bazuara nga literatura e bollshem nga autorët vendor dhe të huaj. Në këtë kapitull kandidatja paraqet të dhëna për bimët bollshem nga autorët vendor dhe të huaj. Në këtë kapitull kandidatja paraqet të dhëna për bimët hiperakumuluese të metaleve, klasifikimi i tyre në bazë të familjeve dhe kapacitetit maksimal të akumulimit të metaleve, duke u bazuar në referenca të shumta nga autorët e huaj dhe ata vendor. Këtu akumulimit të metaleve, duke u bazuar në referenca të shumta nga autorët e huaj dhe ata vendor. Këtu jepen të dhëna për bimën *Alyssum Montanum* dhe *Stachys Scardica*, karakteristikat e përgjithshme dhe përhapjen e tyre. Gjithashtu në këtë kapitull jepen të dhëna për Faktorin bioakumulues (BF) dhe zhvendosjen e metaleve (TF) nga një organ në tjetrin.

Punimi arsyetohet për nga qëllimi dhe rëndësia e tij në kapitullin **"Qëllimi dhe rëndësia e punimit"**.

Në kapitullin **materiali dhe metodat e punës**, kandidatja paraqet të dhënat për regionin e marrjes së mostrave, mënyrën e marrjes së mostrave dhe zberthimin e tyre, si dhe pajisjet e përdorura për zberthimin e mostrave dhe analizimin e tyre.

Kapitull qendror në këtë punim është **"Rezultatet e hulumtimit dhe diskutimi"**, ku kandidatja prezanton të dhënat eksperimentale për dheun dhe bimët e analizuara *Alyssum Montanum* dhe *Stachys Scardica*. Bazuar në të dhënat e fituara, kandidatja prezanton përqendrimet të metaleve të analizuara, statistikën bazike (mesatare, minimum, maksimum etj), koreacionin e Pearsonit ndërmjet elementeve kimike, si dhe analizën cluster për të arsyetur prejardhjen e metaleve në dheun dhe bimët e hulumtuara. Në këtë kapitull, kandidatja diskuton rezultatet dhe arsyeton të gjeturat e saj duke i krahasuar rezultatet e fituara në këtë hulumtim me ato nga literatura e kohëve të fundit nga kjo fushë studimi.

Në kapitullin **përfundimet**, kandidatja bazuar në të dhënat eksperimentale dhe diskutimin e tyre nxjerr përfundime të logjikshme për faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e metaleve në dheun e lokacioneve të ndryshme, bartjen e metaleve nga dheu në pjesët e ndryshme të bimëve, si dhe faktorët të cilët i dallojnë në akumulimin e metaleve në organet e ndryshme në bimët e hulumtuara.

**Literatura** e cituar është aktuale dhe e qëlluar për punimin e paraqitur, dhe gjithashtu reflekton pozitivisht në përcjelljen e zhvillimeve të kohës sa i përket akumulimit të metaleve specifike në bimët hiperakumuluese, si dhe përdormimi i këtyre bimëve në pastrimin e tokave të ndotura me metale potencialisht toksike.

### **Vlerësimi dhe propozimi**


Punimi i masterit i kandidates **Violeta Hajdari** paraqet hulumtim original në fushën e bimëve hiperakumuluese. Rezultatet e këtij punimit janë arritur me përkushtim si rezultat i punës hulumtuese në terren në muajt qershor-korrik 2023, si dhe punës laboratorike (shtator-dhjetor 2023) në zberthimin dhe

analizmin e mostrave të hulumtuara. Këto rezultate janë të rëndësishme për plotësimin e të dhënave për bimët hiperakumuluese të Kosovës.

Komisioni për vlerësimin e këtij dorëshkrimi e vlerëson pozitivisht Punimin e masterit të kandidates **Violeta Hajdari**, me titull "**Faktorët e bioakumulimit dhe zhvendosjes së metaleve nga bimët e familjes Brassicaceae në masivin e Goleshit**" / "Bioaccumulation and translocation factors of metals from plants of the Brassicaceae family in the Goleš massif". Poashtu, Komisioni i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Departamentit të Kimise si dhe Këshillit Mësimor-Shkencor të FSHMN-së që punimin në fjalë ta pranojë dhe të formoj Komisionin për mbrojtje publike të Punimit të Masterit me qëllim të arritjes së titullit: Master i Shkencave të Kimisë (Programi: Kimi fizike dhe inorganike).

Prishtinë, 15.07.2024

Komisioni:

1.   
/ Prof. Ass. Dr. Flamur Sopaj – kryetar/
2.   
/ Prof. Dr. Musaj Paçarizi – anëtar (mentor)
3.   
/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.